

Република Северна Македонија

ООУ „НАИМ ФРАШЕРИ

Неготино Полошко



Republika e Maqedonisë së Veriut

SHFK "NAIM FRASHËRI"

Negotinë e Pollogut

LETËRNJOFTIMI I SHKOLLËS



- Të dhënat e përgjithshme për shkollën
- Emri i shkollës fillore SHFK "NaimFrashëri"
- Adresa , komuna , vendi 101 p.n. Negotinë, Komuna e Vrapçishtit
- Telefon 042311093
- Faks 042311093
- Email ou.naim.frasheri@gmail.com
- Gjuha në të cilën mbahet mësimi -Gjuhë shqipe .

SHFK"Naim Frashëri" Negotinë është themeluar me vendim të Këshillit Komunal të qytetit të Gostivarit me nr: 05-9808 me datë: 24.12.1965 dhe e mbante emrin SHF "Vllezërit Frashëri" Negotinë, më vonë , dmth për arsye politike të sistemit monist me akt numër: 1791000 të vitit 1972 shkolla riemërohet "25-Maji" dhe kur sistemi komunist bie, me vendim të këshillit drejtues të shkollës, shkolla sërish riemërohet në SHF "Naim Frashëri" me akt numër: 1465/10 29.06.1996

SHFK"Naim Frashëri" Negotinë ofron kushte për arsim nxënësve sipas programeve të BYROSE PËR ZHVILLIM TË ARSIMIT. Në shkollën tonë mbretëron një klimë pozitive që nxit mësimin kreativ e zhvillon mendimin kritik dhe paraqet nxitje intelektuale për të gjithë. Nxënësit janë motivimi ynë, janë shumë të rëndësishme rezultatet dhe të arriturat e tyre, zhvillimi i tyre individual dhe vlerat e tyre njerzore. Gjatë vitit shkollor nxënësit tanë marrin pjesë në gara të shumta komunale ,rajonale ,republikane në lëmi ë ndryshme në gjuhë,shkenca,art dhe sport . Poashtu nxënësit tanë marrin pjesë edhe në aktivitete jashtëmësimore që organizon shkolla: 1.Pranimi i nxënësve në klasë të parë 2.Festivali i lojave 3. Nxënësi dhuron për nxënësin 4.Art dhe paqe 5.Panairi i ushqimit 6.Lojra sportive 7.Festat e Nëntorit 8. Ditët e Naimit etj.

Pranimi i nxënësve në klasë të parë



"Nxënësi dhuron për nxënësin"

Projekti ndëretnik "Ndërtojmë ura"



Seminare

Ekipa e Volejbollit



Festat e Nëntorit

